



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

Furnizimi me material fidanor të perimeve

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës, të aplikojnë për furnizim me material fidanor të perimeve, për kultivim në ambient të hapur, si dhe në ambient të mbyllur – serra.

Kulturat:

- Fidanë të specave “*Somborka*” (djegës) F1,
- Fidanë të specave “*Amanda*” (pa djegës),
- Fidanë të specave të bardhë të gjatë (pa djegës),
- Fidanë të specave të bardhë të gjatë (djegës),
- Fidanë të specave të kuq,
- Fidanë të preshve (purrive),
- Fidanë të lakrave të bardha,
- Fidanë të lakrave të kuqe,
- Fidanë për tranguj të vegjël (F1),
- Sallata dimërore “*therrajka*”.

Kriteret e përgjithshme:

1. Aplikuesi duhet të ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës dhe të jetë banor rezident i saj;
2. Fermerët me sipërfaqe të planifikuara për mbjellje, prej 0.02 deri 0.10 ha, do të përkrahen vetëm për një kulturë perimtare - material fidanor;
3. Fermerët të cilët kanë sipërfaqe më shumë se 0,10 ha do të përkrahen me të gjitha kulturat perimtare - material fidanor;
4. Para mbjelljes së kulturave fidanore, toka duhet të jetë e përgatitur komform kërkesave të kulturës së planifikuara për mbjellje;
5. Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
6. Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë toka më qira, duhet të kenë marrëveshje të nënshkruara nga palët, në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Kriteret specifike:

1. Në kushte të barabarta, përparësi kanë zonat me prioritet të identifikuar nga Komuna;
2. Njohuri elementare në fushën përkatëse;
3. Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
4. Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
5. Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
6. Familja (fermerët) pa asnjë anëtar të punësuar(përparësi);
7. Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
8. Infrastruktura përcjellëse (burimi i ujit, sistemi ujitjes);
9. Konfiguracioni i terrenit.

Dokumentacioni:

1. Numri identifikues i fermerit (NIF);
2. Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
3. Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme, jo më e vjetër se një vit;
4. Marrëveshja në mes palëve – nëse toka është me qira, për një (1) vit;
5. Vërtetimi i tatimit në pronë për vitin 2020;
6. Dëshmi nga institucioni përkatës rreth statusit të punësimit (nëse posedon).

Data e aplikimit, prej 05.11.2021 deri më 19.11.2021